



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:254039

Datë: 08.02.2024

Numri i dokumentit: 05302707

C.nr.1355/2017

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, me gjyqtarin Përparim Zeka, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Q. Sh. K. S. E. “ P. i R. K. S.” me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson F. G. sipas autorizimit, kundër të paditurit Z. I. nga Prishtina lidhur me çështjen juridiko-kontestimore Anulim i kontratës, jashtë seance me datë 08.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET së është tërhequr padia e paditëses Q. Sh. K. S. E. “ P. i R. K. S.” me seli në Prishtinë, kundër të paditurit Z. I. nga Prishtina, lidhur me çështjen juridiko-kontestimore Anulim i kontratës, lënda sipas shenjës C.nr.1355/2017.

A r s y e t i m

Paditësja, më datën 05.04.2002 ka ushtruar padi në këtë gjykatë, kundër të paditurit Z. I. nga Prishtina lidhur me çështjen juridiko-kontestimore anulim i kontratës.

Gjykata më datën 24.01.2024 ka mbajtur seancën e shqyrtimit përgatitor, në të cilën është konstatuar se nga fletë dërgesa e Postes së Kosovës i padituri ka rezultuar si i panjohur, pas kësaj në të njëjtën datë gjykata i ka kthyer në plotësim padinë paditëses, për ta precizuar adresën e palës së paditur.

E njëjta aktvendimin për plotësim e ka pranuar me datën 24.01.2024, mirëpo brenda afatit të caktuar paditësja nuk kanë vepruar sipas udhëzimeve si në aktvendim, dhe nuk i kanë dërguar adresën e të paditurit gjykatës, andaj në bazë të nenit 99 lidhur me nenin 102 par.3 të

Ligjit të Procedurës Kontestimore, konsiderohet që paditësja e ka tërhequr padinë në këtë çështje juridike.

Andaj, gjykata në kuptim të dispozitave nga neni 99 lidhur me nenin 102 par.3 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.1355/2017, më 08.02.2024

Përparim Zeka

Gjyqtar

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit të së njëjtit, për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të dorëzohet në ekzemplarë të mjaftueshëm për gjykatën dhe palët.